



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 45
Prishtinë, më 22 mars 2017, në orën 09:00
Ndërtesa e Kuvendit, Salla 409

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Faton Topalli, Ali Sadriu, Hajdar Beqa, Synavere Rysha, Naim Fetahu dhe Bali Muharremaj.

Munguan: Fikrim Damka, Abdyl Ymeri dhe Enver Hoti.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Antigona Ibraj, koordinatorë e Komisionit, Mehmet Simnica, zyrtar i fushës për ekonomi dhe Mentor Hyseni, GIZ.

Pjesëmarrësit e tjerë në takim: Shpend Ahmeti, Gazmend Muhaxheri, Mimoza Kusari-Lila, Agim Bahtiri, Muharrem Sfarqa, Vladeta Kostiq, kryetarë të komunave. Besnik Osmani, Qerkin Bytyçi, Zuke Zuka dhe Qendresa Mulaj, ZKA. Lirije Sylja, Komuna Ferizaj (drejtoreshë e Financave). Zenel Ahmetaj ZKF Prizren. Agim Krasniqi zv. ministër, Kosum Aliu dhe Salvador Elmazi nga MF. Mahir Yagcilar, ministër dhe Tefik Mahmuti nga MAP. Zvonko Stanković nga Komuna Graçanicë dhe Musa Ibishi nga Komuna Ferizaj.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

- 1. Shqyrtimi i Raportëve të Auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunave, për vitin 2015.**

Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1.Shqyrtimi i Raporteve të Auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunave, për vitin 2015

Faton Topalli, kryetar, i njoftoi të pranishmit se sot jemi mbledhur për Shqyrtimin e Raporteve të Auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunave, për vitin 2015. Me këtë e hapi diskutimin:

Besnik Osmani, ZKA, tha se tashmë kanë publikuar pasqyrat vjetore financiare për vitin 2015 dhe se janë në prag të publikimit të pasqyrave financiare të vitit 2016. Ai sqaroi se që nga java e ardhshme do të publikohen raportet e para të Komunave. Po ashtu përmendi tri çështjet që e shqetësojnë Auditorin, e që janë Prokurimi Publik, menaxhimi i pasurive financiare dhe pagesat e palëve të treta.

Qerkin Bytyçi prezantoi mangësitë kryesore që janë vërejtur nga Auditori. Ai u fokusua me shumë në problemet më të theksuara në fushën e prokurimit publik, duke vlerësuar se ka pasur mangësi të çështjeve procedurale dhe se në këtë fushë është aspekti i mbikëqyrjes së kontratave.

Mentor Hyseni, GIZ, theksoi se GIZ-i e ka mbështetur komisionin në organizimin e këtij takimi për të diskutuar për të gjeturat e Auditimit për vitin 2015.

Shpend Ahmeti ka adresuar çështjen e pasurisë të paluajtshme, sipas tij kjo është një nga sfidat kryesore që ka Komuna e Prishtinës. Po ashtu ka përmendur edhe ndarjen buxhetore duke treguar se ndarja e buxhetit bëhet nga Ministria e Financave, në formë të Grandit, pa i marrë parasysh kërkesat e Komunës, në mundësin për të realizua planin e të hyrave.

Mimoza Kusari-Lila ka numëruar një varg problemesh me të cilat i ka Komuna që ajo drejton në raport me nivelin qendror. Si problem ajo e ka paraqitur kur Thesari ekzekuton, pagesa për kompani, të cilat në qeverisjen e kaluar kanë marrë punë pa tender. Tani Thesari i MF-së po i ekzekuton pagesat nga buxheti i Komunës së Gjakovës për Operatorët ekonomik.

Agim Bahtiri, kërkoi nga Kuvendi i Kosovës që vendimet që merr për Komuna të mbulohen nga ministritë përkatëse me shkresa dhe procedura të duhura, sepse kështu komunës do të ishin reduktuar disa probleme të cilat po hasim çdo ditë. Komuna e Mitrovicës ka mbi 15,000 banorë të zhvendosur e për të cilët ne nuk kemi buxhet të ndarë për ta.

Vladeta Kostiq theksoi se Komunat ballafaqohen me probleme prej më të ndryshmeve. Unë desha të fokusohem në disa pyetje për të cilat Auditorët i kanë paraqitur në të gjeturat në raportet e Auditimit. Numri i popullatës në Komunën e Graçanicës është disa herë më i lartë se sa kufiri i përcaktuar i shpenzimeve të dhënë nga Ministria e Financave. Po ashtu theksoi se problem në vete është edhe regjistrimi i Pasurisë, edhe pse për këtë ekzistojnë dy sisteme për regjistrimin e pasurisë. Ne kemi, po ashtu, numër të lejuar për të punësuar, por nuk kemi buxhet të mjaftueshëm për rekrutimin e stafit, për këtë nuk na është lejuar rekrutimi i stafit. Po ashtu ndarja e Buxhetit për Subvencione dhe Transfere pa një plan paraprak. Këtë vit komuna jonë ka bërë planifikimin e buxhetit për kategorinë e subvencioneve sipas një plani të aprovuar në Asambleen Komunale.

Gazmend Muhaxheri tregoi për problemet që ka hasur prej kohës që ka marrë detyrën si Kryetar i Komunës, si problem kyç ka përmendur Ligjin për Pagat. Si rast konkret ka përmendur Arsimin dhe Shëndetësinë, që nuk po mundet të shpallet konkurs në këto drejtime për arsye se po ka njerëz të punësuar edhe pse nuk janë të nivelit përkatës si kuadër.

Muharrem Sfarqa theksoi se te mallrat dhe shërbimet, përkundër investimeve që janë bërë, nuk ka pasur ngritje në komuna, po ashtu problemet më të mëdha që ka në Komunën e Ferizajt janë edhe në bashkë financim sepse ka vonesa në pagesa nga njëra palë, dhe në këtë rast po ka vonesa edhe në realizimin e projekteve sipas planifikimeve me investime kapitale.

Agim Krasniqi, zv. ministër i Financave, gjatë diskutimit të tij theksoi se këto raporte në mënyrë të detajuar tregojnë të gjitha problemet që ekzistojnë. Sipas tij, këto raporte përkundër problemeve që kanë komunat, tregon se ato kanë filluar të kenë një performancë më të mirë krahasuar me vitin paraprak. Zv. ministri Krasniqi tha se tashmë kanë filluar t'i zgjidhin problemet një nga një dhe se kanë intervenuar në Ligjin e Prokurimit Publik, me ndryshim plotësimin e tij.

Mahir Yagcilar, ministër i Administratës Publike tha se sa i përket pasurisë dhe çështjeve të tjera, kjo ministri afon mundësi që të bëhet një menaxhim më i mirë, në mënyrë elektronike.

Ali Sadriu theksoi se tri çështjet që kemi kërkuar nga Auditori është Fusha e Prokurimit, Trajtimit të çështjes së Pasurisë Komunale dhe Subvencionet.

Mimoza Kusari-Lila tha se kufijtë buxhetore dhe shkalla e lartësisë së të hyrave na përcaktohet nga ministria e Financave, gjë që e bënë që komuna pas çdo projekti që dëshiron të bëjë i kufizohet nga kufiri i buxhetit strikt i Ministrisë së Financave, që nuk është e mjaftueshme.

Hajdar Beqa tha se duhet të jetë një lidhje më e mirë mes pushtetit lokal dhe atij qendror dhe kjo lidhje të jetë më funksional. Vonesa në realizimin e projekteve, vonesa në paga pa një arsye të caktuar, pagesa përmes përmbaruesve privatë, bashkë financimi i projekteve të financuara nga donatorët pa ndonjë mbikëqyrje nga stafi i Komunave.

Synavere Rysha kërkoi nga Ministria e Financave dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ndarje sa më e drejtë e buxhetit, investimet kapitale dhe mallra e shërbime. Dhe kërkoi që këto kërkesa të merren seriozisht dhe me një kujdes të shtuar nga ministria. Nga disa kryetarë të komunave u tha se nuk janë pajtuar me të gjeturat dhe rekomandimet, mendoje se kjo është e papranueshme, sepse raporti për t'u finalizuar duhet të kalojë nëpër disa faza. Sot ishte problemi i buxhetit që nuk po bëhet një ndarje e drejtë e kufirit të shpenzimeve dhe keq klasifikimet e buxhetit. Në disa raste kemi ndarje të bursave për studentët pa pasur buxhet të ndarë në atë kategori ekonomike. Pagesat para përfundimit të projektit është problem i ngritur edhe nga Auditori i Përgjithshëm. Të punësuar me kontratë në vepër në mbi 1.300 të punësuar është shqetësuese kjo dukuri.

Zenel Ahmetaj, ZKF Prizren, theksoi se si problem kyç që kanë hasur tash e disa vite dhe që kanë marrë kritika nga auditorët është keq klasifikimi i kategorive ekonomike e kjo po vazhdon të ndodhë realisht duhet të rritet kjo kategori që mos me ndodh për aq sa është e mundur. Po ashtu si problem së fundi në Komunën e Prizrenit është shfaqur edhe në planifikimin e buxhetit

në nën kategorinë ekonomike, dhe kërkoi që të kenë një trajnim një ditë për të reduktuar këtë problem.

Faton Topalli, kryetar, theksoi se pas shqyrtimit të këtij raporti, komisioni u akordua që të diskutojë sërish në mbledhjen e radhës këtë çështje, për të nxjerrë rekomandimet konkrete, në mënyrë që të eliminohen problemet të cilat janë hasur në këto komuna.

Përfundim

KMFP, vendosi që në mbledhjen e radhës së Komisionit të vendoset për rekomandimet e mundshme, të cilat do të nxirren nga diskutimet e të pranishmëve.

Takimi përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Faton Topalli